



Kolegji AAB



## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

mes

Kolegjit AAB, Prishtinë, Kosovë

dhe

Universitetit "Kadri Zeka", Gjilan, Kosovë

### Preambulë

Kolegji AAB, me seli në Prishtinë dhe Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan (në vijim të përmendur si "Palët"), të vetëdijshëm për përfitimet reciproke që rrjedhin nga bashkëpunimi akademik dhe shkencor, pajtohen që të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi për të ndërtuar ura bashkëpunimi në fusha me interes të përbashkët për studentët dhe stafin akademik e administrativ të të dy institucioneve.

### Neni 1: Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të vendosë një kuadër të përgjithshëm për bashkëpunim ndërinstitucional në:

1. Zhvillimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta ndërmjet studentëve dhe stafit akademik të të dy institucioneve.
2. Organizimin e aktiviteteve akademike dhe shkencore, si konferenca, seminare, punëtori dhe tryeza të rrumbullakëta me interes të përbashkët.
3. Zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar përmes zyrave për marrëdhënie ndërkombëtare të të dy institucioneve, duke përfshirë pjesëmarrjen në projekte të përbashkëta ndërkombëtare, shkëmbim për qëllime zhvillimore dhe rritjen e kapaciteteve institucionale.

### Neni 2: Fushat e Bashkëpunimit

Palët angazhohen të bashkëpunojnë në këto fusha:

1. Projekte të përbashkëta kërkimore dhe zhvillimore ku përfshihen studentët dhe stafi akademik.
2. Organizim i përbashkët i ngjarjeve akademike si simpoziume, punëtori, trajnime, dhe konferenca.

3. Bashkëpunim për zhvillim të kapaciteteve ndërkombëtare përmes zyrave për marrëdhënie ndërkombëtare, për të iniciuar dhe zbatuar projekte të financuara nga programe ndërkombëtare (si Erasmus+, IPA, Horizon Europe, etj.).
4. Promovimi i aktiviteteve të përbashkëta publike dhe publikimeve shkencore.

### **Neni 3: Zbatimi**

1. Secila palë do të caktojë një koordinator për të ndjekur zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe për të lehtësuar komunikimin ndërmjet institucioneve.
2. Aktivitetet specifike do të përcaktohen në marrëveshje të veçanta (aneksë) ku do të përshkruhen kushtet, përgjegjësitë dhe burimet financiare për realizimin e secilës nismë.
3. Palët do të takohen të paktën një herë në vit për të shqyrtuar progresin dhe për të planifikuar bashkëpunimet e ardhshme.

### **Neni 4: Promovimi i Bashkëpunimit dhe Dukshmëria**

1. Palët pajtohen që të publikojnë logot dhe vegëzat zyrtare përkatëse të faqeve zyrtare të njëra-tjetres në faqet e tyre zyrtare gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes.
2. Qëllimi i këtij vizibiliteti është forcimi i imazhit të bashkëpunimit institucional dhe rritja e transparencës dhe vizibilitetit publik.

### **Neni 5: Kohëzgjatja dhe Ndërprerja**

1. Marrëveshja hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi për pesë (5) vite.
2. Çdo palë mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje me njoftim të shkruar së paku gjashtë (6) muaj përpara.
3. Marrëveshja mund të zgjatet apo ndryshohet me pajtim të ndërsjellë dhe me shkrim të të dy palëve.

### **Neni 6: Dispozita Përfundimtare**

1. Kjo Marrëveshje nuk krijon obligime ligjore apo financiare për palët, përveç kur ndryshe specifikohet në marrëveshje shtesë.
2. Çdo mosmarrëveshje eventuale do të zgjidhet me mirëkuptim dhe konsultim ndërmjet palëve.

### **Neni 7: Ligji në fuqi**

Kjo Marrëveshje do të interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës.

Për Kolegjin AAB  
Dr. Sc. Blerim Olluri

Rektor  
Data: 02/06/2025



Për Universitetin "Kadri Zeka"  
Prof. Asoc. Dr. Artan Dermaku

Rektor  
Data: 02/06/2025

